

UDHËZIM
Nr.18, datë 11.5.2011

PËR MASAT PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË LIRIMIT 2011

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.7592, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1013, datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)”,

UDHËZOJ:

1. Provimet e lirimimit 2011 të fillojnë në orën 10:00 dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta.
2. Procedurat e hartimit të testeve përcaktohen në rregulloren “Për zhvillimin e provimeve të lirimimit në Republikën e Shqipërisë”, nr.592, datë 1.2.2011.
3. Në shkollat e pakicave kombëtare (greke dhe maqedonase) zhvillohet provimi i lirimimit në gjuhën amtare.
 - a) Për shkollat e pakicës kombëtare greke teza do të përgatitet nga DAR Gjirokastrë, ZA Delvinë dhe ZA Sarandë, tërheqin në DAR Gjirokastrë tezën në ditën e provimit.
 - b) Për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase teza përgatitet nga DAR Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit nga drejtori i shkollës, i shoqëruar nga përfaqësuesi i DAR-së Korçë.
 - c) Hartimi i testit për provimin e lirimimit në gjuhën amtare do të ndjekë të njëjtën procedurë sipas pikës 1 të këtij udhëzimi.
4. Për Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë, testi të tërhiqet në AKP nga drejtorja e institutit një ditë para zhvillimit të provimit, që e kthen atë në sistemin e shkrimit BRAIL.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi: Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Edukimit Parauniversitar, Drejtorja e Programeve të Zhvillimit, Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Koordinimit Rajonal, Drejtorja e Shërbimeve të Përgjithshme, AKP-ja, IKAP-ja, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj